



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

Objekti: Shërbime Organizimi të Eventeve Sportive (CPV – 92622000-7)

Tabela e Përmbajtjes

Terma Reference për Organizim Event Sportiv të organizuara nga "Ekipet Sportive në Shkollë"
"Procedure Prokurimi për Shërbime Multifunksionale të Organizimit dhe Menaxhimit të Eventeve Sportive në kuadër të projektit "Ekipet Sportive në Shkollë".

<i>Ref: Shërbime Rekreative Kulturore dhe Sportive</i>	
1. Rreth KOKSH	2
2. Rreth shërbimit të kërkuar	2
3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi	4
4. Metodologjia dhe plani i punës	3
5. Kualifikimet e nevojshme	3
6. Procesi i aplikimit	4
7. Dorëzimi i ofertave	5
8. Afati i Aplikimit	6
9. Procesi i Vlersimit	6
10. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak	6



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

1. Rreth KOKSH

KOKSH është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj.

KOKSH është pjesë e Lëvizjes Olimpike dhe angazhohet plotësisht të respektojë Kartën Olimpike dhe Kodin Antidoping të Lëvizjes Olimpike, si dhe të jetë konform me vendimet e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe legjislacionin e shtetit Shqiptar.

2. Objekti i shërbimit të kërkuar: Sherbime organizimi te ngjarjeve sportive dhe kulturore.

Për të përmbushur misionin e organizatës dhe për të shpërndarë frymën Olimpike më tej, KOKSH planifikon të organizojë evente sportive, ndeshjet në bashki, ndeshjet në nivel qarku, dhe ndeshjet finale të përmbylljes së kampionatit për periudhën 01.03.2025 - 15.06.2025 sipas kalendarit të ndeshjeve dhe sipas nevojave për çdo event që do të organizohet.

Nëpërmjet kësaj thirrje të hapur, KOKSH fton individët/ekipet/kompanitë e interesuara të paraqesin ofertën e tyre sipas specifikimeve të mëposhtme.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi.

Nr.	Emërtimi	Specifikim Teknik	Njësia	Sasia	Cmim/Nj ësi	Vlera/Lek	Burimi i Financimit	Kohezgjatja
1	Procedure Prokurimi per Sherbime Multifunkionale te Organizimit dhe Menaxhimit te Eventeve Sportive ne kuader te projektit "Ekipet Sportive ne Shkolla"	Realizim eventesh te ngjarjeve sportive ku te ofroje sherbimet dhe materialet si: -Projektor, Led Wall - Fletpalosje - Transport punonjesish - Transport materiale+pastrime - Pedane -Dj, Foni - Flamuj te ndryshem - Lule dekorimi te ndryshme - Ndricim - Animatore - Koriondole - Adezive	Numer sherbimesh	Sherbime	10.000.000 leke	10.000.000 leke	Qeveria Shqiptare financim projekti "Ekipet Sportive ne Shkolla".	3 muaj ne disa Qarqe sipas kalendarit te ndeshjeve te miratuara nga Ekipet Sportive

4. Metodologjia dhe plani i punës

Do të kontaktohet indiv/ekip/kompani i cili do të propozojë oferten me te mire per kryerjen e organizim eventesh sportive. Subjekti duhet të paraqesë një metodologji të qartë pune, e cila përfshin:

- Përshkrimin e hapave për organizimin e aktiviteteve (përgatitja, montimi, zbatimi, çmontimi).
- Planin e punës me kalendar të detajuar për çdo ditë aktiviteti.
- Menaxhimin e burimeve njerëzore (stafi teknik, animatore, ndihmës logjistik, etj.)
- Sigurimin e cilësisë dhe mbikëqyrjen gjatë realizimit të çdo komponenti.
- Strategjinë për përfshirjen aktive të fëmijëve dhe garantimin e sigurisë së tyre.
- Mekanizmat për zgjidhjen e problemeve të papritura gjatë eventit.
- Dokumentimin e aktivitetit (foto, video, raporte të shkurtra).



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

5. Kualifikimet e nevojshme

Kualifikimet:

- Të jetë i regjistruar në QKB si ofrues shërbimesh në fushën e organizimit të eventeve.
- Të ketë eksperiencë të dokumentuar të paktën 2 (dy) vite në organizimin e aktiviteteve të ngjashme.
- Të zotërojë pajisjet ose të ketë kapacitetin për t'i siguruar ato në mënyrë të garantuar (fonia, ndriçimi, skena, LED wall, etj.).
- Të ketë staf të specializuar për animacion fëmijësh, teknikë të fushës audio/ndriçim, dhe staf logjistik mbështetës.
- Të jetë në gjendje të ofrojë sigurim për aktivitetin dhe stafin në rast incidentesh.
- Të mos jetë i përfshirë në ndonjë procedurë ligjore që e përjashton nga pjesëmarrja në tenderë publikë.

6. Procesi i aplikimit

Për të aplikuar në këtë thirrje kërkohet:

- Oferta Financiare per event.
- NIPT-in e biznesit
- Adresen e sakte.

7. Dorëzimi i ofertave

Për të aplikuar në këtë thirrje ju lutem dërgoni ofertat tuaja në zarf të mbyllur në emër të Sekretarit të Përgjithshëm të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar Z. Gerti Shima, në adresën:

Tirana Olympic Park

Rr. "Liman Kaba"

Tiranë, Shqipëri

P.O. Box 63

Email: secretary.general@nocalbania.org.al

8. Afati i Aplikimit

- Propozimet duhet të dorëzohen në adresën e mësipërme deri në datë 10.03.2025 jo më vonë se ora 16:00.
- Ofertat duhet të dorëzohen në gjuhën Shqipe.



KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

9. Procesi i Vlerësimit

Vlerësimi do të kryhet sipas sistemit të pikezimit si më poshtë vijon:

Përshkrimi	Pesha në vlerësim %
Eksperiencat e punës/CV e firmës/individit	20%
Eksperience në organizim eventesh të ngjashme.	40%
Staf dhe pajisjet teknike të nevojshme për organizimin e eventit.	40%

10. Informacion nëse është përdorur njoftim paraprak.

Nuk është përdorur njoftim paraprak në lidhje me këtë lloj shërbimi të kërkuar.